Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;JO

b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

---

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit të ketë një vlere sa 40% i Marrveshjes Kuader. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre viteve të fundit.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

#### 2.4

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

a. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës se fondit limit të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2015-2016-2017).

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

#### Për testet:

1. Operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë origjinën e mallit (testeve), kompaninë prodhuese, vendin e prodhimit si dhe kodin e katalogut ( të plotësohet në shtojcën 1 të DST).

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kataloget teknike / broshura / fletpalosje origjinale për artikullin e ofruar. **Ne katalogë, broshure apo flete palosje, duhet të markohet artikulli i ofruar (testi).** (Keto dokumente duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me

dokumentacionin e kërkuar në këto DT).

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001 ose ekuivalent të prodhuesit të testeve deklaruar në formularin e ofertesë;
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e konformitetit CE të testit që ofron;
5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi për ofrimin e testeve të kërkuara në këtë procedurë prokurimi.

✓ **Për pajisjen që ve në përdorim pranë QKTGJ:**

6. Autodeklarate ku saktësohet Nr. dhe tipi i analizatorit përfshirë aksesoret e tij të cilin OE do ta instalojë duke bashkelidhur materialin përshkrues:

- a. Lloji i pajisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit., gamen e plote të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi.
- b. Gjithashtu të deklarohet se diskriminimi i infeksioneve për çdo dhurim të rezultuar pozitiv ofrohet falas.

*Shenim: Aparatura, të jete e teknologjise se viteve 2015, 2016 ose 2017, sipas specifikimeve teknike të DST.*

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001 ose ekuivalent të prodhuesit të pajisjes;

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën CE të pajisjes që ofron;

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi për ofrimin e kësaj pajisje në funksion të përdorimit të testeve nga AK sipas specifikimeve teknike të DST.

10. Vetedeklarim që bashkë me sasine e reagenteve do të sigurojë edhe pajisjen sipas kërkesave të DST.

11. Ofertuesi duhet të paraqesë referenca ku të vërtetohet se sistemi është në përdorim në të paktën 5 laboratore të BE me ngarkesë ditore të ngjashme/instrument ku sistemi i ofertuar është në përdorim.

12. Ofertuesi duhet të paraqesë katalogun përkatës të pajisjes që ve në përdorim të QKTGJ.

13. Deklarate për trajnimin e personelit që do të përdorë aparaturat dhe do të kryejë analizat. (6 persona).

14. Të dhënat për personelin e asistencës teknike ku në stafin e OE të këtyre të paktën një inxhinier të trajnuar dhe certifikuar për mirëmbajtjen e kryer për këto aparat. Inxhinieri duhet të jete i pajisur me certifikatën e trajnimit përkatës.

Për këto të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës ( të inxhinierit),
- b. listë pagesat e sigurimeve shoqërore për muajt Janar – Shkurt 2018 ku të figurojë në stafin e kompanisë
- c. certifikatat e trajnimit

*Sqarim: Mospermbushja e kritereve kualifikuese lidhur me pajisjen qe ofron ne perdorim eshte kusht per skualifikim.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]



Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sistemi objekt i i kesaj procedure prokurimi duhet te perfshije :

- Dhenien në përdorim gratis të analizatorit te diagnostikimit NAT, prodhim i viteve 2015, 2016 ose 2017 shoqeruar me listen e aksesoreve te nevojshem per mireperdorimin e tij etj, deri në fund të kohëzgjatjes së kontratës.
  - *Sherbimin gratis të asistences teknike* për funksionimin e sistemit përfshirë materialet e konsumit, materiale të kancelerise, etj., të nevojshme për funksionimin e pajisjes, sipas kërkesave të AK.
  - *Kurse trajnimi gratis* per stafin përdorues (6 persona).
  - Furnizimin me teste sipas kërkesës së QKTGJ-së. ( kundrejt pageses)
1. Sherbimin e asistences teknike i cili siguron:
    - Instalimin e sistemit dhe desinstalimin e mevoneshem ne fund te periudhes kontraktuale.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- Mirembajtja e pajisjes me shpenzimet e kompanise fituese sikurse parashikohet nga manual i perdorimit te pajisjes i cili duhet te jete ne gjuhen shqip ose anglisht. Ne rast mosfunksionimi te analizatorit apo aksesoreve, nderhyrja e personelit te asistences te behet brenda 24 oreve dite pune nga lajmerimi.
- Mirembajtja e pajisjes me shpenzimet e kompanise fituese sikurse parashikohet nga manual i perdorimit te pajisjes i cili duhet te jete ne gjuhen shqip ose anglisht.
- Kurse trajnimi per perdorimin e sistemit per te pakten 6 persona
- Furnizimi me materiale konsumi, materiale te kancelerise, etj te nevojshme per funksionim normal te pajisjes.

### Kërkesa teknike:

1. Per analizatorin dhe aksesoret e tyre:
  - Nr. dhe tipin e analizatorit perfshire aksesoret e tij te cilin OE do ta instaloje duke bashkelidhur materialin pershkrues;
  - Aparatura dhe aksesoret duhet ti korespondojne modelit te fundit te kompanise, prodhim i viteve te fundit 2015, 2016 ose 2017 te hedhura ne treg.
2. Per sherbimin e asistences:
  - Listen e pjeseve te kembimit te cilat do te perdoren me qellim mirembajtjen e zakonshme te pajisjes nga QKTGJ (letra , boje etj)
  - Deklarate për trajnimin e personelit që do të përdorë aparaturat dhe do të kryejë analizat. (6 persona).
3. Per reagentet:
  - Specifikimet teknike te cilat duhet te jene konform DST
  - Listen dhe sasite, perfshire skeden teknike dhe skeden informative
4. Per produktet komplementare (kalibratore, etj) te paraqese:
  - Listen e produkteve dhe materialeve komplementare te cilat duhet te ofrohen falas , brenda sherbimit, nga OE i cili do te lidhe kontraten.
  - Materiale të tjera të nevojshme
  - Materialet e konsumit per printer si dhe ata per shtypjen e analizave te pacientit etj.

### Oferta ekonomike duhet te permbaje :

- **Emrin e kitit/ reagentit dhe cfare diagnostikon testi HIV 1, HBV, HCV.**
- Nr. i kodit te katalogut
- Sasia (përcaktuar nga AK)
- Cmimi per njesi
- Cmimi Total

Duke gene se kontrata parashikohet per nje periudhe kohe 12 muaj nevojiten 34 000 kite dhe reagente ne total per testimin me metoden NAT.

### **Specifikime teknike te pajisjes per testimin e gjakut me metoden NAT**

Sistemi per testimin e gjakut me metoden NAT duhet te kete tiparet e meposhtme:

1. Sistem automatik i integruar, i afte per te kryer testimin e mostrave te gjakut me metoden NAT per agjentet viral infektiv HCV, HIV1 dhe HBV.
2. Platforma duhet te ofroje dhe opsionin e testimit te gjakut per HIV2.
3. Platforma NAT per testimin e gjakut duhet te jete nje instrument i vetem dhe te jete plotesisht automatik ne te gjitha fazat e kryerjes se procedures se testimit me metoden NAT .
4. Platforma HIV 1 per testimin e dhuruesve te gjakut duhet te jete e afte te detektoje te pakten 2 regjione te genomes me qellim kapjen e mutacioneve te mundshme te virusit HIV 1 per nje siguri maksimale te gjakut e komponenteve.
5. Sistemi duhet te jete i pershtatshem per te dhene rezultatet e rreth 150 mostrave ne me pak se 8 ore **me testim individual te dhurimeve.**
6. Sistemi duhet te jete me ngarkese te vazhdueshme, si edhe me testim dhe dhenie rezultatesh te vazhdueshme me frekuence te larte, me qellim kursimin maksimal te kohes/stafit. Ofertuesi duhet te paraqese nje grafik te menaxhimit te punes gjate nje 8-oreshi si edhe te pershkruaje rrugen e nje mostre te vetme nga momenti i futjes ne aparat deri ne marrjen e rezultatit. Po keshtu ofertuesi duhet te pershkruaje rrugen dhe kohen per marrjen e rezultatit te trefishte per nje moster STAT.
7. Sistemi duhet te garantoje nje testim sa me te shpejte te mostrave emergjente. Per te gjykuar ne lidhje me kete, OE duhet te pershkruaje saktesisht si i menaxhon sistemi i ofruar mostrat emergjente per te siguruar akses sa me te shpejte ne rezultat, dhe duhet te specifikojte saktesisht kohezgjatjen ne marrjen e rezultatit HCV/HBV/HIV per nje moster STAT, nga momenti i vendosjes se saj ne analizator deri ne marrjen e rezultatit.
8. Sistemi duhet te garantoje ekstraktimin e acideve nukleike te viruseve, amplifikimin dhe detektimin e tyre automatik te gjitha ne nje tub te vetem me qellim qe te kursethet maksimalisht koha e operatorit per t'u pershtatur sa me mire me organizimin 8-oresh te punes ne QKTGJ, dhe me domosdoshmerine e dhenies se pergjigjes sa me te shpejte te testimit ne kushtet e pamjaftueshmerise me gjak.
9. Sistemi duhet te jete i pajisur me bar-code per leximin dhe identifikimin direkt te tubave te reaksionit, dhe te jete i pershtatshem per te lexuar bar-codet ISBT 128, code 39, code 128. Sistemi duhet te ofroje lidhje bidireksionale me LIS (Laboratory Information System). Ofertuesi duhet te garantoje kete lidhje per QKTGJ.
10. Sistemi duhet te kete marken CE dhe te jete ne perdorim ne **te pakten 5 vende te BE.**

**Ofertuesi duhet te paraqese referenca nga te pakten 5 laboratore te BE me ngarkese ditore te ngjashme/instrument ku sistemi i ofertuar eshte ne perdorim.**

11. Sistemi eshte i preferueshem qe te kerkoje pranine e jo me shume se dy operatore per turn, per perpunimin kompletimin e procesit, dhe leshimin e te dhenave. Sistemi duhet te ofroje alarme per nje komunikim sa me te mire me operatore te cilet kryejne edhe detyra te tjera nderkohe qe sistemi eshte duke punuar.
12. Sistemi duhet te kete nje software te lehte per perdorim dhe te ofroje back-up te te gjitha skedareve te lidhura me operimin.
13. Sistemi duhet te jete i afte te rregjistroje te gjitha aktivitetet e kryera nga aparati. Gjithashtu duhet te siguroje evidence per demtimet e mundshme apo mirembajtjen e sistemit.
14. Sistemi duhet te jete i afte te identifikojte mostra te papershtatshme (p.sh koagula, sasi e pamjaftueshme, etj.).
15. Sistemi duhet te ofroje gjurmim te reagenteve.
16. Sistemi duhet te ofroje sasi sa me te vogla mbeturinash me qellim mbrojtjen e mjedisit.
17. Sistemi duhet te jete afte te leshoje nje numer te madh raportesh qe te perfshijne te pakten sa me poshte:
  - a. Identifikimin e instrumentit
  - b. Identifikimin e perdoruesit
  - c. Datën dhe kohen e fillimit e kompletimit te analizave
  - d. Numrin e lotit te reagenteve duke perfshire edhe datat e skadences
  - e. Rezultatet e testimit
  - f. Referenca te tjera te kerkuara per operimin sa me te pershtatshem te sistemit
18. Rezultatet duhet te paraqiten si raporte te pergjithshme si edhe raporte te nje mostre te vetme.
19. Ushqimi per aparatin duhet te jete 220-230V, 50-60Hz.
20. Ofertuesi duhet te siguroje mbeshtetje teknike per trajnimin e personelit dhe per mirembajtjen e aparatit.
21. Sistemi duhet te zere sa me pak vend per t'u pershtatur sa me mire me mjedisin tone laboratorik. Per te gjykuar ne lidhje me kete, OE duhet te pershkruaje me sakte si madhesine e pajisjes, gjurmen, peshen si dhe kerkesat elektrike dhe hidraulike per instalim.
22. Sistemi duhet te garantoje kohe sa me te gjate te mundshme te ruajtjes se stabilitetit te reagenteve. Per te gjykuar ne lidhje me kete, OE duhet te pershkruaje qendrueshmerine e kitit te hapur dhe qendrueshmerine "on board" per te gjitha reagentet, te paraqitur si kohe totale qendrueshmerie edhe brenda frigoriferit kur reagenti eshte i hapur.
23. Ofertuesi duhet te kompletojte sistemin me UPS (uninterrupted power supply) i pershtatshem qe te stabilizojte rrymen e shperndare dhe ne te njejten kohe te perballoje nderprerjet e energjise pa humbje te te dhenave. UPS duhet te garantoje nje pavaresi per te pakten 30 min.
24. Ofertuesi duhet te marre persiper investimin e duhur per te bere te mundur pastrimin e ujit per perdorim ne aparat.



**Specifikime per reagentet ( testet) per testimin e gjakut me metoden NAT**

1. Reagentet duhet te jene te pershtatshem per perdorim ne testimin e gjakut me metoden NAT.
2. Testimi duhet te jete individual
3. Reagentet duhet te jene te licencuara dhe te pajisur me marken CE per perdorim ne bankat e gjakut.
4. Reagentet duhet te jene te kalibruara sipas standardeve europiane nderkombetare me ndjeshmeri sa me maksimale analitike per viruset HIV-1, HCV dhe HBV te vertetuar me studime klinike. Ndjeshmeria duhet te jete minimalisht per HIV-1 <40 UI/ml, per HCV < 10 UI/ml, HBV <7 UI/ml.
5. Skadenca e mallrave do të jete jo me pak se 6 muaj nga data e dorezimit te tyre. Testet e ofruara duhet të jenë të përshtatshme për përdorim për aparatoren qe ofron.
6. Ofertuesi duhet te paraqese:
  - a. Certifikatat ISO dhe CE
  - b. Autorizim prodhuesi
  - c. Kataloget teknike / broshura / fletepalosje origjinale

**Afati i levrimit per paisjen : brenda 15 ditesh nga data e lidhjes se kontrates**


Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Kuadër		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>		
<b>02</b>		
<b>03</b>		
<b>...</b>		



## Shtojca 12

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)


### SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

**Sasia e mallit që kërkohet:** Sipas specifikimeve teknike të lart shënuara

Duke qene se kontrata parashikohet per nje periudhe kohe 12 muaj nevojiten :  
Sasia: 34 000 kite dhe reagente ne total per testimin me metoden NAT.

**Afatet e lëvrim:** Sipas specifikimeve teknike të lart shënuara

**12 muaj nga data e lidhjes se Marreveshjes Kuader**



**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>1</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

**Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor ]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_

*numri i NIPT-it*

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që

kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së

mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës se shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvruara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.

- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe pakeluar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe pakeluar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimin.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

### **Neni 13: Kushtet e Dorëzimit**

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

### **Neni 14 Transportimi i Mallrave**

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuara në kontratë.
- 14.2 Në Autoritetin Kontraktor është i detyruar të marrë Mallrat nga ndonjë mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet të japë lajmërim paraprak të arsyeshëm për transportin dhe t'i dorëzojë Autoritetin Kontraktor të gjitha dokumentat e nevojshme për marrjen e Mallrave.
